

JANI THOMAJ

## MBI KUFIJTË E FJALËS NË GJUHËN SHQIPE DHE DISA ÇËSHTJE TË DREJTSHKRIMIT

Problemi i fjalës në gjuhën shqipe është një nga më të vështirët në studimet leksikologjike. Në gjendjen e tanishme të këtyre studimeve ai është rrahur më pak se shumë probleme të tjera, kështu që ende nuk i kemi të përcaktuar plotësisht vetë konceptin mbi fjalën, vendin dhe kufijtë e saj në vargun e njësive themelore të gjuhës, veçoritë që e dallojnë nga këto njësi, lidhjet ndërmjet formës dhe kuptimit, rolin e saj jo vetëm brenda sistemit leksikor, por edhe në nënsistemet e tjera të gjuhës, etj. Zgjidhja përfundimtare e këtyre çështjeve do të krijonte në të njëjtën kohë një bazë shkencore e një-sore (unike) edhe për trajtimin e shumë mjeteve e kategorive gjuhësore në fushën e fonetikës, të morfologjisë, të sintaksës e të formimi të fjalëve. Në fushën e fonetikës fjala duket shpesh herë si

1) Për të kuptuar rëndësinë e këtyre studimeve rreth fjalës, po sjellim këtu diskutimin e njohur, që është shtruar gjërë kohët e fundit në gjuhësinë shqiptare, rreth klasifikimit të pjesëve të ligjeratës. Pranohet përgjithësisht se pjesët e ligjeratës janë kategori leksiko-gramatikore. Kjo do të thotë që ato, në radhë të parë, janë njësi leksikore, d.m.th. fjalë. Si rrjedhim, edhe nyja e përparme, që numërohet si pjesë më vete e ligjeratës, është njësi leksikore, d.m.th. fjalë. Mirëpo, a ka vërtet tiparet e fjalës ky element?

Mendojmë se në kategorinë e nyjes duket bërë një ndarje e qartë ndërmjet atyre të mbiemrit (*i, e, të së mirë*) dhe atyre të gjindores (*i, e, të, së baba*), i nyjeve me vlerë pronori të emrave të farefisit (*i, ati, e ëma, të atit, së ëmës*). Nyjet e mbiemrit nuk kanë asnjë tipar të fjalës: Së pari, nuk kanë fare kuptim leksikor, qoftë edhe të dobësuar a të zbehur, ato shërbejnë si mjete (gramatikore) për format e fjalëve, si mbaresat, për të shprehur kuptimin e gjinisë, të numrit e të rasës, që siç dihet, janë kuptime gramatikore. Nga funksionet dhe kuptimet gramatikore kategoriale këto nyje ngjajnë me nyjet e prapme. Përkundrajt këtyre nyjeve, ato të gjindores së emrit (të pashkëputur nga emri në rasën përkatëse dhe nyjet me vlerë pronori kanë një kuptim leksikor (ndonëse të zbehtë), atë të pronësisë, të të përkulturit; Së dyti, nga pikëpamja e strukturës morfologjike të gjuhës, mbiemri i nyjshëm (*i mirë*), lakohet njësoj me emrin e shquar (*mur-i*), padyshim në planin e përgjithshëm strukturor, duke lënë mënjanë veçoritë që rrjedhin nga paravënja ose pasvënja (prepozicioni e postpozicioni) dhe nga dallimet kuptimore gramatikore të të dy formave. Në fund të fundit, në të dy rastet format ndërtohen me ndihmën e varianteve morfologjike të nyjeve. Së treti, bashkë me trajtimin e nyjeve në përgjithësi si kategori leksikogramatikore lind pyetja: Tek *i mirë*, leksikisht kemi një fjalë apo dy fjalë? A kemi këtu një formim thjesht morfologjik (pra, një fjalë nga ana leksikologjike), apo në trajtë analitike të formuar me mjete leksikore (pra, dy fjalë nga ana leksikologjike). Në të njëjtën mënyrë shtrohet problemi edhe për disa

një objekt jo i drejtpërdrejtë, veçanërisht në aspektin fonetik e më përdrejtë, veçanërisht në aspektin fonetik e më pak në atë fonologjik, kurse përkundrazi në drejtshkrim ajo del qartësisht si një objekt i drejtpërdrejtë. Në fund të fundit, cili është ai element i përhershëm që përshkon gjithë trajtimin drejtshkrimor? Sipas mendimit tonë, ky element është fjala, pasqyrimi grafik me besnikëri ndaj ligjeve të gjuhës i strukturës fonomorfologjike të saj, ngulitja në shkrim e figurës së saj shqiptimore ose fjalëformuese<sup>2</sup>, ruajtja dhe paraqitja e saj si një njësi e përfunduar. Edhe çështjet e veçanta fonetike, si drejtshkrimi i zanores ë, i grupeve bashkëtingëllore, i alternimeve të tingujve etj. sillen, tek e fundit, rreth strumbullarit të fjalës. Këtej duket rëndësia që merr edhe për drejtshkrimin, interpretimi i fakteve mbi një bazë të drejtë leksikosemantike. Në disa raste, pavarësisht nga parimet e përgjithshme të pranuar, kjo është pasur parasysh në «Projektin e rregullave të drejtshkrimit të shqipes» (1967). Mjafton të përmendim për këtë shkrimin e disa fjalëve bashkë e ndaras sipas kundërvënjes *kuptimore*<sup>3</sup>.

«pjesëza formëformuese «si *do, të (të punojë, do të vij)*, për të cilat mund të thuhet po ato, që u thanë edhe për nyjet e mbiemrit.

Është pranuar me të drejtë në gjuhësi formimi i trajtave analitike me majete leksikore, si kohët e pathjeshta të foljeve (kam punuar etj.), shkallët e mbiemrave e të ndajfoljeve (shumë i mirë, më mirë etj.). Foljet ndihmëse e gjysmëndihmëse, si dhe fjalët e shkallës, me gjithë dobësimin e kuptimit leksikor, e ruajnë atë, madje në sistemin gjuhësor funksionojnë edhe si njësi të pavarura me kuptim leksikor të mëvetësishëm, pra si njësi leksikore.

Kjo është një nga çështjet më të vështira të morfologjisë shqipe, që do të gjejë një zgjidhje të drejtë nëpërmjet studimesh të mëtejshme të thelluara. Ajo që duam të nënvizojmë me këtë rast është mendimi se ky problem (dhe jo vetëm ky në fushën e morfologjisë) do ta gjejë këtë zgjidhje vetëm kur studimi i tij të mbështetet në një konceptim të drejtë të fjalës si njësi e leksikut të shqipes.

2) Kjo varet nga pikënisja ose parimi i pranuar: Do të pasqyrohet në drejtshkrim figura shqiptimore e fjalës apo do të ruhet qartësia e strukturës morfofjalëformuese. Pranimi i njërës nga këto parime ka rëndësi të veçantë për shumë zgjidhje drejtshkrimore.

3) Në «Rregullat e drejtshkrimit të shqipes» (DH § 1, shënimet 1-4) mbi këtë bazë semantike, që shoqërohet edhe me dallime të karakterit fonetik (si theksi e pauza), bëhet kundërvënja ndërmjet *atëherë* (unë po) kthehem dhe *atë herë* (që s'erdhe), (na ishte) *njëherë* (një plak) dhe *një herë* (në ditë), (kam) *qëkur* (*qyshkur*) (që po pres) dhe *që kur* (*qysh kur*) (ra shi, u ftoh moti), *përse* (nuk erdhi?) dhe *për se* (është fjala?), (nuk erdhi) *ngase* (s'kish kohë) dhe *nga se* (bëhet letra?), *nëse* (nuk vjen, më shkruaj) dhe *në se* (qëndron ndryshimi midis A-së dhe B-së?), *ndërsa* (po bisedonim) dhe *ndër sa e sa* (çështje që u shqyr-tuan), *seç* (këndon bilbili) dhe *se ç'* (i ka ngjarë), (s'ka) *sesi* dhe (na udhëzoni) *se si* të veprojmë etj. Po kjo gjë duhet bërë edhe me disa njësi që nga pikë-pamja semantike-funksionale janë përngjitur, si *patjetër*, *padashur*, *padyshim*, *pandërprerë*, *papërrjashtim* etj. Ato, siç dihet, kanë kuptim ndajfoljor ose kryej-në funksionin e fjalëve të ndërmjetme, por atë kuptim ose funksion nuk e ka njëra gjymtyrë, e ka delokutivi në tërësi, i njësuar në një fjalë të vetme. Shkalla e desemantizimit ose ndonjëherë edhe e risemantizimit del në dritë gjatë kundër-vënjes së tyre me togjet përgjegjëse me gjymtyrë që funksionojnë veç njëra nga tjetra, si p.sh. (do ta bëj) *patjetër* (këtë punë) dhe *pa tjetër* (mjet kjo punë s'bë-het), (i bëra dëm) *padashur* dhe *pa dashur* (të zgjatëm më shumë...), *padyshim* (kjo dihej dhe më parë) dhe (erdhi) *pa* (ndonjë) *dyshim*, (të punojmë dy orë) *pandërprerë* dhe *pa ndërprerë* (punën), (të gjithë) *papërrjashtim* dhe (s'ka rre-gull) *pa përjashtim*, (iku nga mbledhja) *pakuptuar* dhe (s'mund ta ndreqësh një gabim) *pa kuptuar* (se ke bërë gabim), (flet) *papushim* dhe (lëvizja) *pa* (ndonjë)

Dihet se në vargun e njësive bazë të gjuhës (fonema-morfema-fjala-togfjalëshi-fjalia) *fjala* zë vend ndërmjet *morfemës* dhe *togfjalëshit*. Po të vendosim kufi të qartë në të dyja anët e fjalës, ndërmjet saj dhe njësive fqinje të shkallës më të ulët e të shkallës më të lartë, atëherë kemi vendosur kufijtë e vetë fjalës në gjuhën shqipe, e kjo do të ndihmojë drejtpërdrejt në saktësinë e drejtshkrimit të një vargu fjalësh, veçanërisht nga ato që në «Rregullat e drejtshkrimit të shqipes» trajtohen te kapitujt «DH. Shkrimi i fjalëve bashkë dhe ndaras» dhe «E. Shkrimi i fjalëve bashkë dhe me vizë në mes».

Deri më sot nuk ka ndonjë studim të veçantë kushtuar problemit të fjalës në gjuhën shqipe. Studimet e gramatikave e hartuara kanë dhënë shpesh herë zgjidhje empirike ose tradicionale, si dhe në përputhje me kërkesat e praktikës mësimore kur ka qenë rasti i trajtimit të problemeve gramatikore që lidhen drejtpërdrejt me fjalën. I pari që është marrë me studimin e fjalës në gjuhën shqipe nga pozitat e teorisë së leksikologjisë është A. Kostallari, në punimet për formimin e fjalëve në gjuhën shqipe<sup>4</sup>. Autorin e sjell vetë lënda e shqyrtuar te studimi i fjalës në vetvete dhe te kërkimi i tipareve të saj që mund të shërbejnë si kritere për të dalluar kufijtë në mes fjalës e togfjalëshit. Ato vëzhgime që janë kryer për kompozitat, si dhe përgjithësimet që nxirren prej andej për veçoritë kryesore të këtyre fjalëve, vlejné edhe për fjalët e thjeshta e të prejardhura, pra për fjalën në përgjithësi si njësi leksikore. Është kështu për dy arsye: Së pari, se fjalët e përbëra e të përngjitura janë gjithashtu fjalë dhe kanë të njëjtat veçori kategoriale me fjalët e thjeshta e të prejardhura; Së dyti, se të gjitha llojet strukturore të fjalëve (të thjeshta, të prejardhura, të përbëra e të përngjitura) i përkasin të njëjtit nivel, nivelit leksikor, ndonëse strukturalisht pasqyrojnë shkallë të ndryshme, sipas një shkallëzimi progresiv, ku fjala e thjeshtë ose tema e saj hyn si përbërëse e strukturave më të larta. Nga kjo kuptohet vetiu se çdo veçori kategoriale e këtyre strukturave më të

*pushim* (nuk bën mirë) etj.; shih edhe J. Thomaj, Rreth «Rregullave të drejtshkrimit të shqipes», SF 1968 IV 183. Çfarë del nga kjo kundërvënje? Së pari, tek njësité njëfjalëshe (atëherë, njëherë, qëkur, përse, ngase, nëse, ndërsa, seç, sesi, patjetër, padashur, padyshim, pandërprerë, papërgjashtim, pakuptuar; papushim etj.), kuptimi leksikor i gjymtyrëve është zbehur ose është ndryshuar, por në çdo rast ai nuk mund të veçohet tani nga njësia e tërë, ai ka vlerë brenda së tërës dhe shkrihet në të për të dhënë një kuptim të ri kategorial; mjafton të vëzhgohen për këtë herë, kur, se, sa, ç, si, tjetër, dashur, kuptuar, etj. si gjymtyrë fjale dhe si fjalë më vete. Së dyti, njësité njëfjalëshe kanë humbur edhe trajtat e gjymtyrëve të tyre (krh. për këtë papushim dhe pa pushim-e, padyshim dhe pa dyshim-e, atëherë dhe atë herën (e dytë) etj. Së treti, njësité njëfjalëshe krijojnë të tjera marrëdhënie sistemore, e kjo vjen nga kuptimi i ri që kanë fituar (krh. njëherë «dikur» dhe një herë (jo: «dy, tre etj. herë»), pakuptuar «fshehurazi», pa dashur «pa dëshirë», papushim «vazhdimisht» dhe pa pushim «pa u shlodhur, pa interval» etj. Kundërvënja semantike nuk është gjithherë aq e qartë sa të çojë në krijimin e lidhjeve të reja sistemore.

Pas kësaj nxjerrim përfundimin se nga ana leksikologjike atëherë, njëherë, etj. janë fjalë të vetme e shkruhen bashkë, kurse atë herë, një herë etj. janë togje fjalësh që përbëhen nga dy njësi të veçanta leksikore, prandaj shkruhen ndaras.

4) Shih A. Kostallari, Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe, BUSht, SShSh, 1961 III 3-20 dhe «Kompozitat dëshirore dhe urdhërore në shqipen», SF 1968 IV 23-64.

larta të të njëjtit nivel (leksikor) është e padyshimtë edhe për ato më të ultat. Çështja është të ndajmë njësitë e niveleve të ndryshme, si ato të nivelit morfologjik nga ai leksikor dhe këtë të fundit nga ai sintaksor. Në ndarjen e parë nuk lindin shumë vështirësi për shqipen, me përjashtim të trajtimit të nyjeve të mbiemrit dhe të disa pjesëzave<sup>5</sup>. Përkundrazi, më e vështirë është të vendosësh kufi të prerë midis njësive të pathjeshta leksikore (si fjalët e përbëra, të përngjitura e, më pak, të prejardhurat) dhe njësive sintaksore (si togfjalëshat, lokucionet e në këtë mes, vetëm në pikëpamje strukturore, frazeologjizmat gjuhësorë)<sup>6</sup>. Pas kësaj drejtshkrimi e ka të lehtë të vendosë një rregull të përgjithshme, sipas së cilës ç'është fjalë të shkruhet bashkë dhe ç'është njësi më e lartë se fjala, e nivelit sintaksor, të shkruhet ndaras. Vijnë kështu tek thelbi i fjalës në gjuhën shqipe dhe veçoritë e saj kryesore që e dallojnë nga togfjalëshi.

\* \* \*

I. Një tipar themelor, pa të cilin fjala nuk mund të ekzistojë, është kuptimi leksikor tërësor dhe i mëvetësishëm. Ajo ka aftësinë të na japë diçka nga realiteti, duke na lidhur me një send ose me një raport a shfaqje tjetër çfarëdo. Kur flitet për fjalën, në radhë të parë kuptojnë këtë anë të saj dhe e përdorin «kuptimin leksikor tërësor e të mëvetësishëm» si kriterin kryesor që e ndan fjalën nga morfema e nga togfjalëshi i lirë. Mirëpo ky kriter nga disa autorë është interpretuar jo drejt, ose është absolutizuar, gjë që ka sjellë vlerësime të gabuara edhe në lëndën konkrete. Kështu p.sh. G. Vaigandi, K. Cipoja etj. e shndërrojnë kriterin semantik në kriterin e shprehjes së «një nocioni të vetëm», madje edhe këtë të fundit e zbatojnë në mënyrë

5) Shih shën. 1.

6) Marrëdhënjet e fjalës së përbërë me togfjalëshin gjenetik janë ndriçuar pak e kjo mund të thuhet jo vetëm për gjuhësinë shqiptare. Ndërkaq këtu fshihet raporti ndërmjet niveleve të ndryshme të gjuhës, ndërmjet përmbajtjes e formës, ndërmjet anës leksikore e gramatikore në gjuhë. Nga ana praktike çështja shtrohet se si të japësh sa më shumë informacion me sa më pak mjete gjuhësore. Sipas disa autorëve, fjala e përbërë dhe togfjalëshi përgjegjës mund të japin informacion të njëjtë, si nga vëllimi ashtu edhe nga cilësia, pra del se fjala e përbërë është një mjet gjuhësor i shprehjes më ekonomik se togfjalëshi i lirë. Këtë zgjedhje të mjeteve gjuhësore më ekonomike ne e vëmë re në gjuhën e folur popullore, ku më dendur përdoren: «djali syzi, vajza flokëverdhë, lepuri veshëgjatë» etj., madje edhe më tutje: «ai syziu, ajo leshverdha, ai veshëgjati», etj. dhe më pak «djali me sy të zes, vajza me flokë të verdhë, lepuri me veshë të gjatë» etj. Një prirje të tillë zhvillimi e vëmë re edhe në fushën e frazeologjisë gjuhësore, ku prej vë re është formuar vërej, baj za — bëzaj, me krahë hapur — krahëhapur, me duar kryq — duarkryq, me ballin lart — ballëlart, me duar plot — duarplot, me duar të arta — duarartë etj. Për këtë të fundit shih Një klasifikim i frazeologjizmave me vlerë ndajfoljorë në gjuhën shqipe, SF 1969 I 34; shih edhe A. П. Комаров, О различии в коммуникативных тенденциях сложного слова и соотносительного словосочетания, në „Филологические науки“ 1970 V 40. Duke shënuar edhe motivet që i japin shtysë këtij procesi të përgjithshëm të gjuhës, Pier Giro shkruan: «...krijohen fjalë me qëllim që të sigurohet një shkëmbim më i mirë i komunikimit: më ekonomik, kur lënë mënjanë një pjesë të fjalëve ose kur i cungojnë ato; më të qartë kur heqin ose zëvendësojnë fjalë të cilat rrezikojnë të krijojnë pështjellime». — P. Guiraud, La sémantique, Paris 1959, 52.

të njëanshme<sup>7</sup>. Është e vërtetë se fjala ka një kuptim leksikor tërësor e të mëvetësishëm, por zbatimi i një kriteri semantik sipas G. Vaigandit e K. Cipos lë vend për tri vërejtje kryesore: a) Dihet se jo të gjitha fjalët shprehin nocion; b) Kuptimi leksikor nuk është i vetmi tipar i fjalës; c) Kuptimi leksikor tërësor e i mëvetësishëm nuk është vetëm tipar i fjalës, por edhe i frazeologjikut<sup>8</sup>, prandaj ai nuk mund të shërbejë në mënyrë të mjaftueshme për ta dalluar fjalën nga togfjalëshat e tipit frazeologjik. Kështu kuptimi tërësor e i mëvetësishëm është kërkesa më e paktë (minimale) për të përcaktuar një njësi si fjalë, por nuk është kriter plotësisht i mjaftueshëm.

Kriteri semantik duhet të plotësohet edhe nga kritere të tjera<sup>8</sup>. Së fundi, në lidhje me këtë tipar, duhet shtuar se ai përfshin të gjitha tipet e fjalës, që nga e thjeshta deri tek e përngjitura.

II. Fjala në gjuhën shqipe ka gjithmonë strukturë të mbyllur, d.m.th. ajo ndryshon si një njësi e tërë e pandashme dhe jo sipas përbërëseve të saj, ndryshe nga togfjalëshi (edhe i tipit frazeologjik, ndonëse ky nuk ka paradigmë të plotë), i cili ka strukturë të hapur. Ky tipar i fjalës nuk është krejt i veçantë për gjuhën shqipe, atë e kanë edhe gjuhë të tjera indoevropiane, veçse në shqipe ai del i rregullt<sup>9</sup> dhe pothuaj<sup>10</sup> i përgjithshëm, gjë që lejon të përdoret si një kriter krye-

7) G. Weigand, në *Albanesische Grammatik im südgegischen Dialekt*, Leipzig, 1913, § 49, merr si kompozita «të mirëfillta» dhe më të rëndësishme të shqipes togjet *gur-mullini*, *buk-thekne*, *vakt-dreke*, *shkam-guri*, *bri-dreni*, *këlysh-macesh*, *ve-rosash*, *bi-sulltani* etj.; po ashtu K. Cipo, në *Gramatika shqipe*, 1949, f. 43, quan kompozita «sui generis» togjet *gur kufiri*, *bukë gruri*, *ve pate*, *lëng pule* etj. Duke shkruar për kompozitat e shqipes, A. Kostallari vëren me të drejtë se «zbatimi i njëanshëm i kriterit semantik e ka çuar K. Cipon të fusë në grupin e kompozitave edhe lokucione, të cilat duken qartë që nuk janë të tilla (p.sh. *nat'e ditë*, *arrën e gurin* etj.), sepse në to çdo fjalë ruan edhe kuptimin e vet, edhe — ç'është akoma më e rëndësishme për karakterin e një strukture — theksin e veçantë» — *Kompozitat dëshirore...* SF 1968 IV 54 shën. 33. Mund të shtojmë se si G. Vaigandi ashtu edhe K. Cipoja nuk vënë kështu kufi midis fjalës dhe togfjalëshit (sidomos të tipit frazeologjik). Është e ditur se në çdo rast kur kemi të bëjmë me fjalë (qofshin edhe kompozita), do të shkruhen bashkë, kurse autorët e mësipërm i shkruajnë me vizë ose ndaras.

8) Shih edhe A. Kostallari, *Kompozitat dëshirore...*, SF 1968 IV 54-55.

9) Krh. frëngjisht *bonshommes*, *gentilshommes*, *mesdames*, *mesdemoiselles*, *messeigneurs* (*nosseigneurs*), *messieurs* etj.; ose: *chefs-lieux*, *oise-aux-mouches*, *sabres-baionnettes*, *lous-garous*, *vagons citernes* etj.; ose: *bains-mari*, *timbres-poste*, *chefs-d'oeuvre*, *arcs-en-ciel*, *coud-de-pied*, *eaux-de-vie* etj.; ose: *arcs-boutants*, *basses-cours*, *francs-maçons*, *grands-pères* etj.; ose: *douces-amères*, *sourds-muets*, *derniersnés* etj.; ose *gardes-boeuf* (s), *gardes-charrues* (s), *gardes-port* (s), *gardes-voies* (s) etj. Përkundrajt këtyre: *des coq-a* — *l'âne*, *des pied-à-terre*, *des pot-au-feu*, *des tête-a-tête* etj. të pandryshueshme dhe: *couvre-lits* *couvre-plats*, *tire-bouchons*, *tire-lignes*, *porte-billets*, *casse-pierres*, *porte-cigares*, *garde-robres* etj. Shih për këto M. Grevisse, *Le bon usage*, Paris 1964, f. 228-234 dhe E. Bled — O. Bled, *Cours supérieur d'orthographe*, Paris 1954, f. 26-28.

10) Ka edhe për shqipen disa përjashtime të pakta, që mund të shpjegohen me natyrën e formimit të fjalëve. Të tilla janë disa përngjitje përemërore, si *kushdo* (kujtdo, këdo), *cilido* (cilitdo, cilindo), *cilado* (cilësdo, cilëndo) e ndonjë tjetër. Tek *dorartë* // *duarartë*, *insekt-ngrënës* // *insektengrënës*, *njëri-tjetrin* // *njëra-tjetrës* etj. nuk kemi trajta të së njëjtës fjalë, po formime të pavarura mbi bazën e temës së njëjësit a të shumësit, të gjinisë mashkullore a femërore, prandaj duhen vlerësuar si fjalë të veçanta. Në disa raste këtu kemi edhe një përqendrim kuptimi, kur njëjësi bëhet përfaqësues i shumësit, si *dorartë* për *duarartë*, *veshllapush* për *veshëllapushë* etj., ku kuptimi edhe i kompozitës me temën e njëjësit ka vlerën e shumësit (*dorartë* «që i ka duart të arta», *veshllapush* «që i ka veshët llapushë»).

sor për të ndarë fjalën nga togfjalëshi. Ky kriter morfostrukturor është edhe më praktik, sepse është më i dukshëm e i sigurtë. Formësimi gramatikor tërësor, nënshtrimi ndaj një paradigme tip për të gjitha kategoritë e fjalëve (që nga e thjeshta), bëhet kështu një tregues i pakundërshtueshëm i përfundimit të procesit të njëfjalësimit të një njësie gjuhësore. Si tregues i parë gramatikor i këtij njëfjalësimi janë mbaresat rasore të shquarësisë, të numrit e të rasës për kategorinë emërore e mbiemërore dhe mbaresat vetore për kategorinë foljore: babagjysh-I, bashkëshort-Ë, aktakuzë-A, gruparmat-A, kryetrima-VE, bashkalidh-IM, -NI, IN, -A,-E,-I etj. Prandaj gjithë emrat e foljet, që kanë një strukturë të tillë të mbyllur dhe një paradigmë të plotë, janë fjalë dhe si të tilla duhen shkruar bashkë. Si tregues gramatikor i njëfjalësimit mund të merret edhe nyja e përparme tek mbiemrat e nyjshëm, tek emrat prejmbiemërorë dhe tek gjindorja e emrave: I ashtuquajtur, I drejtpërdrejtë, I gjithëfuqishëm,

11) Shih edhe Rreth «Rregullave...», SF 1968 IV, 184.

12) Disa emra e folje të këtij tipi ndeshen jo rrallë ndaras a me vizë në botimet tona, por pa asnjë dyshim duhen shkruar bashkë: aeroplanmbajtëse, bashkëkohës, bashkëmohatar, besëlidhje, betonarme, bletëkapëse, breshkujëse, buzëmbremje, druprerës, dhjetëditësh, erëdhë, ferrëbutë, flakëdhënëse, fletanketë, grevëthyes, grupmohë, grykëderdhje, gurgdhendës, gjashtëfishoj, gjysmerrësirë, gjysmëkoloni, gjysmëmbrojtës, gjysmëpërcjellës, hekurkthyes, hekurpunues, juglindje, jugperëndim, kartëmonedhë, kartëvizitë, kohëshënues, korparmatë, kryeagronom, kundërgaz, kundërevolucion, letërthithëse, mbaslindje, mbikafkë, mbikrah, mbishartësë, mesnatë, mijëvjeçar mosbarazi, mosbesim, mosndërhyrje, mospërfillje, nazifashist, ndihmësiagronome, ndihmësgjyqtar, ndihmësmjek, nëndrejtor, nëntokë, parastomak, pesëvjeçar, postbllok, postroje, procesverbal, projektide, projektku-shtetutë, projektligj, projektplan, projektregullore, pulëbardhë, rrufepritëse, samarpunues, shitblerje, shkozëbardhë, shtatzënë, shtrojerë, tetorësh, toslimon, treditësh, tredylmsh, udhëkryq, ujëmbledhës, ujëvarë, vajgursjellës, veshmbathje, vetëedukim, vetëkënaqem, vetëkontroll, vetëkuptohet, vetëshërbim, vetëvendosje, zëvendës-drejtor, zjarrfikës, zhurmëshuese etj.

Janë mbi treqind shembuj të tillë të nxjerrë nga «Kartoteka e drejtshkrimit», pranë sektorit të kulturës së gjuhës dhe nga vjeljet personale, që, jo rrallë i ndeshim të shkruar herë me vizë, herë ndaras, herë bashkë dhe herë në të trija mënyrat, edhe brenda një gazete, jo vetëm në trajtën përfaqësuese, por edhe në trajtën e shquar, në shumës, në rasat e zhdrejta, si: paraqiti akt-akuzën, amper-metrat përdoren për..., lojtarëve të basket-bollit, shënoi besë lidhjen, prej beton armeje, bletë-rritësit e Delvinës, fushave të breg detit, festimi i datë-lindjes, faqe ziu s'e ka për gale, nga zhurmat e flakë-hedhësve, një turmë grevë-thyesish, sipas grup-kulturave, sipas grup-mohës, e grup-armatës, në grykë-derdhjen, brenda hendek-lidhjeve, vitet e mbas lindjes, rreziku i mendje madhësisë, për festën e mes-vjeshtës, muskuli i mbi kafkës, zona e mbi krahut, brazda e mbi syt, thirri ndihmësi-agronomen, gjatë pesë-vjeçarit, goja e qime-kuqit, emrin e ish-armikut etj. Shkrimin me vizë ose ndaras të disa fjalëve e gjejmë në një shkallë të lartë dendurie, si p.sh. mos-përdorim, mos përfillje, mos interesim, mos njohja, mos paraqitja, mos realizimi, mos respektimi, proces-verbal, fletë-rrufe, shit-blerje, tej-pjekje, tetë orëshi, zëvendës-komisar etj. Dallohen për një lëkundje të madhe në të shkruar sidomos formimet semiafiksale dhe ato që kanë strukturë fjalëformuese shumë të qartë. Ndoshta kjo tejdukshmëri e strukturës fjalëformuese, veçanërisht kur krijohet edhe modeli fjalëformues, lejon që gjymtyrët e fjalëve të këtij lloji të përceptohen, në të folur e në të shkruar, si dy njësi të veçanta (kështu dalin në materialet tipat: baba gjysh, bomba hedhëse, bashkë punim, periudha e para çlirimit ose e pas çlirimit, vetë edukimi, mos ndërhyrja etj). Kjo vetëdijë si dhe tradita shkrimore kanë sjellë që disa fjalë të përbëra të depërtojnë edhe në terminologjinë e organeve të shtypit zyrtar. Kështu p.sh. në «Gazetën zyrtare» 1968 II 25 gjejmë: hekur-punuesat, pjata-larës, rroba-larës, zjarr-fikësat, zjarr-fikëse etj.

I herëpashershëm, I lartpërmendur, I lehtëpërdorshëm, I nënshkruari, I paraçlirimit, I pasluftës, I porsalindur, TË rishmartuarve, TË dhjetëditorit, TË pesëvjeçarit etj.<sup>13</sup> Në kategorinë e mbiemrave të panyjë si tregues i njëfjalësimit shërben mbaresa e gjinisë ose e numrit: art-dashës-E, ashtdalë-A, bacilmbajtës-E, ballëgjërë-A, ballëhapur-A, bark-madh-E, cipëbardhë-A, dorështrënguar-A, famëmadh-E, flokëkuq-E, këmbëzbathur-A, kokëderr-I, kuptimplot-Ë, leshashpër-A, sykaltër-A, trupimët-A, trupvigan-Ë, vrarëli-E, zemërçelik-E etj.<sup>14</sup>

Të gjitha këto tipe fjalësh të prejardhura, të përbëra e të përngjitura në parim janë vëzhguar e janë trajtuar drejt në «Rregullat e drejtshkrimit të shqipes» (shih E § 1, 1 dhe 2), porse praktika e botimeve

13) Këtu po japim disa emra e mbiemra me nyjë, që ndeshen jo rrallë ndaras a me vizë në botimet tona, por që pa asnjë dyshim duhen shkruar bashkë: i (e, të) deriatëhershëm (e), i (e, të) deridjeshëm (e), i (e, të) deritanishëm (e), i (e, të) menjëhershëm (e), i (e, të) mëparshëm (e), i (e, të) mëposhtëm (e), i (e, të) mëtejshëm (e), i (e, të) mëvonshëm (e), i (e, të) mirinformuar, i (e, të) paarësyeshëm (e), i (e, të) paaritshëm (e), i (e, të) pafjetur, i (e, të) pafund, i (e, të) pakulluar, i (e, të) pamësuar, i (e, të) pandërprerë, i (e, të) paspjegueshëm (e), i (e, të) pazhvilluar, i (e, të) porsaardhur, i (e, të) porsadalë, i (e, të) porsandërtuar, i (e, të) porsapranuar, i (e, të) sapoformuar, i (e, të) sapokorrur, i (e, të) sapopërfunduar, i (e, të) sipërpërmendur, i (e, të) sipërtreguar, i (e, të) shumëdashur, të shumënumërt, i (e, të) shumëpritur etj. Ndër afërsisht njëqindpesëdhjetë raste të tilla një pjesë të mirë e gjejmë me një denduri shumë të lartë të shkruar gabim, si: *e deri tanishme, të lart-përmendura ose e lartë përmendur, e më parshme, e më poshtme, e më sipërme, e më tejshme, e më vonshme, e herë-pas-hershme ose e herë pas hershme, i sapo ngritur, i sapo zhvilluar, të sipër treguara etj.*

Substantivim vetëm në të shquarën kemi edhe te *i pëртеjoqeanit, i pëртеjlu-mit, i pëртеjdetit*, «qeshi me patëkeqin tim» (Mësuesi, 2.VIII. 1972, 5) etj. Në tre shembujt e parë, si te «periudha e pasluftës», nyja e gjindores luan po atë rol sintetizues si dhe nyja e mbiemrit, ndërkohë që në disa raste, trajta emërore nuk ekziston (*pëртеjoqean, pasçlirim* etj.). Në këtë pikë këto raste mund të për-qasen me mbiemrat *i fundit* nga gjindorja e emrit *fund-i, i zoti* nga *zot, e zonja, nga zonjë* etj.

14) Këtu po japim disa mbiemra pa nyje, që ndeshen jo rrallë ndaras ose me vizë në botimet tona, por që pa asnjë dyshim duhen shkruar bashkë: anti-imperialist, antipopullor, antiajror, antiekonomik, antiimperialist, arësimdashës, bakërmbajtës, bombahedhës, degëmadh, disaditor, disavjeçar, dobiprurës, dritëdhënës, drejtvizor, dyditor, dhjetëvjeçar, faqebuckë, fjalëmbël, fjalëpak, fletëngushtë, flokëbardhë, frutdhënës, fytyrëçelur, fytyrërrumbullak, gojëmbël, gurthyes, gjethem-bajtës, gjetherënës, gjumëdhënës, gjysmanalfabet, insektevrasës, jashtëqendror, jashtëkollor, joaktiv, kapuçbardhë, këndgjërë, kënddrejtë, kufidëftues, lotsjellës, metalprerës, mikrobmytës, mineralmbajtës, nacionalçlirimtar, naftëmbajtës, nam-madh, ndërqelizor, njeriingrënës, njëqelizor, njëvjeçar, parasocialist, rrezeartë, sqep-lugë, sygështenjë, sypërgjumur, sypërlotur, shpatëzhveshur, shpirtkatran, shpirtka-zëm, shpirtthatë, shpresëdhënës, shpretkëfryrë, shtatëkatësh, shtatvogël, shumëde-gësh, shumëkatësh, shumëmilionësh, shumëngjyrësh, tridegësh, trirrokësh, trungçje-rrë, ujëmbledhës, vajgurmbajtës, vajgursjellës, vetëshkarkues, zemërçelik, zemër-madh, zemërzjarrtë etj. Janë mbi dyqind fjalë, ndër të cilat ka një shumicë që shkruhen gabim në një shkallë të lartë dendurie, sidomos të tipit semiafiksial (*anti+*, *gjysmë+*, *jo+*, *pro+*, *shumë+*). Ndoshta në këtë ndikon edhe fakti që me ndonjë prej këtyre semiafiksive (si: *gjysmë, jo*) struktura e mbiemrave të nyjshëm mbetet e hapur (p.sh. *gjysmë të gatshme, gjysmë i zhveshur, jo i përsosur, jo i pastër* etj.). Përkundrazi, nën ndikimin e kompozimit është kryer përngjitja në disa mikrooronime shqipe edhe me humbjen e nyjës së gjindores (shih A. Kostallari, *Kontribut për klasifikimin e tipave kryesorë të kompozitave në fushën e mikrooronimisë shqiptare*, SF 1971 III 57); këtij ndikimi i janë nënshtruar disa fjalë të përbëra njëtrajtëshe, strukturën e mbyllur të të cilave nuk na e zbulon asnjë formant paradigmor (si: *antiparti, zemërhekur, kokëshkëmb* etj.), brendapër-brenda kategorisë mbiemërore.

tona ende nuk i ka ngulitur si duhet. Në këto kategori fjalësh, si dhe në formime më të lashta popullore (të tipit *barktharë, brengëzënë, buzëplasar, derëzi, ditëprerë, dorëtharë, farëhumbur, gojëtharë, shapllamadh, këmbëbigaçe, dhëmbëkrimbur, gjuhëprerë, pikërenë, qafëthyer, syplasar, trudalë, varrvidhisur, vulëhumbur, buzëpaqeshur, farëpalënë, fatpadalë, flokëpakrehur, buzëkuti, gushëkuq, kokëlesh, shpirtkazëm* etj.) me strukturë të mbyllur, nuk lind ndonjë vështirësi teorike për drejtshkrimin.

Tek disa njësi leksikore të pathjeshta mbyllja e strukturës zbulohet edhe nëpërmjet llojit të lidhjes së morfemës trajtëformuese me temën e fjalës. Po të zberthëjmë fjalët *disakuintalësh-e, dykatësh-e, dykursorësh-e, dhjetëditësh-i, dhjetëvjeçar-i, pesëgarësh-i, shumëkëmbësh-i* etj. do të nxjerrim si gjymtyra të dyta *-kuintalësh-e, -katësh-e, -kursorësh-e, -ditësh-i, -vjeçar-i, -garësh-i, këmbësh-i*, etj., të cilët nuk funksionojnë veçan në gjuhë me mbaresa të tilla, gjë që tregon se këto mbaresa u përkasin njërive në tërësi dhe jo vetëm gjymtyrëve të dyta.

Po t'i përmbahemi këtij kriteri strukturor, atëhere zgjidhim problemin e drejtshkrimit për gjithë ato njësi që i nënshtrohen ose që nuk i nënshtrohen një sistemi paradigmor, pavarësisht nga gjymtyrët, lloji i lidhjes, shkalla e desemantizimit dhe e risemantizimit etj. që vihen re në këto njësi. Rrjedhimisht duhen shkruar bashkë fjalë të tilla si *farefis, fëshfëshje, takatuke, leitmotiv, mirëseandhje, pingpong, thashetheme, zigzage* etj.<sup>15</sup> Fusim këtu edhe disa përngjitje eufemistike të përfunduara e me paradigme të plotë, si *dritëpastë-i, gojëlidhur-i, gojëmbërthyer-i, gojëmbyllur-i, gojëthatë-i, largnesh-i, mospastëpjesë-i, ndjesëpastë-i, i paudhë-i qoftëlarg-u, ruajnazot-i, shtojzovallë-ja* etj. Në kundërshtim me «Projektin e rregullave të drejtshkrimit të shqipës» (shih E § 1, 3 për disa raste si *bar-bufe, postë-telegraf* etj.) mendoj se njësi të tilla duhet të shkruhen bashkë, sepse kanë strukturë të mbyllur, që shpreh prirjen e shqipes së sotme letrare për sintetizimin

15) Po japim këtu disa raste të kësaj natyre që në botimet tona dalin me lëkundje të mëdha, por që duhen shkruar bashkë: është i vetmi për *allishverishe*, puna e palodhur e *asimzenelasve*, kjo është meritë e *baletmaestrit*, e gjeta në *barbufenë* e ndërmarrrjes, soleta prej *betonarmeje*, dëgjoheshin *çapejaket, çikçaket* e shetëve, morën fund *ecejaket*, kishte thirrur gjithë *farefisin*, marrëdhënje *farefisnie*, m'u çu *fëshfëshja*, u mërzita nga *hyrjedaljet*, era e *kokakolës*, me *leitmotivin* e pjesës, shtresa e *letërkatramasë*, paraqiti *letërkredencialet*, s'e kishte me vete *letërnjoftimin*, *letërqarkorja* e komitetit, lavdi *marksizëmleninizmit*, në mes të atij *mishmashi*, i uroi *mirëseardhjen*, dëgjoheshin *pllaqeplluqet* e opingave në baltë, hartoi *plandetyrën*, direktivat e *projektplanit*, hartimi i *projektrregullores*, trullosja nga *rokendrolli, safetspahiasit* e Shkodrës, shkolla e *shurdhëmemeceve, tak-taku* i zemrës, *tamtamet* e revolucionit, *tingtanget* e çekiçëve, *trakatruket* e potkojve, *tiktaku* i sahatit, *traketraku* i tezgjahut, u thye para *thashethemeve*, shpërthyen *urratë*, fituan *vojokushasit*, u lodhëm nga *vajtjeardhjet*, në shumë pjesë të këtyre *zigzageve* shkisinim *barkas* etj. Në ndërgjegjen gjuhësore të zakonshme disa nga këto formime ndjehen ende si të përbëra nga dy gjymtyrë të veçanta e kjo pasqyrohet në shkrim me vizë. Kjo vjen si pasojë e ndikimit të huaj tek fjalët e huazuara (si *bar-bufe, rok-end-roll* etj.) dhe nga qartësia e strukturës morfematike tek fjalët onomatopeike (si *tam-tam-et, tik-tak-u* etj.). Mirëpo nuk mund të merret me mend shkrimi i tyre me vizë, si për arësytet e dhëna, ashtu edhe për arësye të sistemit fjalëformues, sipas të cilit sot në mënyrë zotëruese shkruhet *asimzenelas, vojokushas* etj.

e mjeteve të shprehjes, rritjen e prodhimitarisë së përbërjes e të përngjitjes dhe fuqinë e madhe asimiluese të shqipes për fjalët e huazuara. Mbi bazën e këtyre tri tipareve të rëndësishme janë njëfjalësuar ose po njëfjalësohen përfundimisht (e ky proces duhet pasqyruar edhe në drejtshkrim) edhe disa formime relativisht të reja me emra foljorë, me përcaktim rasor ose me marrëdhënje atributive etj., të cilat kanë krijuar tashmë një model të pasur e të qëndrueshëm në gjuhën, si *aktpajtim, fletëhyrje, fletështrim, fletëthirrje, vendvarrim* etj.<sup>16)</sup>

Përballë këtyre njësive njëfjalëshe kemi disa formime me strukturë të hapur ose që strukturalisht a semantikisht nuk përshtaten me natyrën e ligjet e gjuhës e si të tilla duhen trajtuar si togfjalësha, të shkruhen ndaras e pa vizë.

Të tillë kemi, së pari, një lloj togfjalëshi ku gjymtyra e dytë është në funksion atributi a ndajshtimi kundrejt së parës dhe, me gjithë një farë bashkësie kuptimore ndërmjet tyre, nuk shkrihen në një fjalë të vetme strukturalisht të mbyllur. P.sh. *dyqan shtëpi, dhomë muze, hotel klub, organizatë bazë, parti mëmë, qytet hero, qytet muze, rrugë qorre, vinç kullë, xham qorr* etj. Dihet që ky tip nuk ka paradigme tërësore as në të pashquarën (shih «e një organizatë bazë, e një qytetI hero» etj.), as në të shquarën e në shumës (shih «e organizatëS bazë, qytetIT hero, organizatAVE bazë, qytetEVE hero» etj.). Strukturalisht të papranueshme si një fjalë janë edhe disa togje fjalësh që kanë gjithashtu një farë bashkësie kuptimore, por jo të natyrës së fjalës, si: të dala *jashtë përdorimit arësye pa kuptim, i vë pa kursim në shërbim të atdheut, punoj pa ndërprerje, punë pa përgjegjësi, tani është pa punë, vendim pa themel, ishte shpirt njeriu* etj.<sup>17)</sup> Po të shikohen këtu lidhjet sistemore të kundërvënjes, të afërisë etj., edhe ato flasin për struktura të hapura (krh. *pa kuptim- me kuptim, pa punë — në punë, etj.*).

Në radhë të dytë vijnë këtu disa grupe fjalësh të trajtuara si kompozita, sipas mendimit tonë gabim, sepse janë në kundërshtim me modelët dhe rrugët e zhvillimit semasiologjik të fjalëve. Në botimet tona, deri edhe në letërsinë speciale zyrtare, këto togje shkruhen me vizë dhe të leksikalizuara plotësisht. (Kjo gjendje është pasqyruar edhe në «Projektin e Rregullave të drejtshkrimit...» (shih E § 2,4). P.sh. seksioni i *arësim-kulturës*, reparti i *axhusteri-montimit*, drejtorja e *boni-*

16) Po kështu: *fletëshërbim, fletëdalje, lajmëthirrje, lejëkalim, letërnjoftim, pikëvrojtje, rrugëzgjdhje, sheshpushim, urdhërxhirim, vendbanim, vendburim, vendlindje, vendmbrojtje, vendqëndrim, vendtakim, vetëdukim, vetëmësim, vetëmjekim, vetëngacmim* etj. Këto fjalë jo rrallë i gjejmë edhe të shkruara ndaras ose me vizë, d.m.th. si struktura të hapura, gjë që pasqyron procesin ende të pakryer përfundimisht të njëfjalësimit të tyre. Kjo ka lidhje edhe me shkallën e dendurisë së përdorimit. Po të shikojmë të ardhmen e këtij procesi, kur edhe modeli tashmë është formuar (krh. *datëlindje, ditëlindje, rrugëdalje, tatimfitim, vetëveprim, vetëmohim, vetëshërbim, vendbanim, vendlindje, etj.*), atëherë s'ka dyshim që ato do t'i nënshtrohen plotësisht këtij modeli. Për zhvillimet leksikogramatikore që ndodhin gjatë kalimit nga togfjalëshi në një fjalë të vetme (për univverbizimin e sintagmës) shih A. Kostallari, *Mbi disa veçori...*, BUSH, SShSh, 1961 III 11. Bashkë duhen shkruar edhe disa formime të llojeve të ndryshme, por me emra jofoljorë, si: *aktkontroll, ekstrattanin, fletafishe, fletëngarkesë, fletërrufe, fletëstatistikë, kërkesëpadi, vendkomandë* etj.

17) Këto i gjejmë dendur të shkruara bashkë.

*fikim-ujitjes*, dyqani i *fruta-zaravateve*, uzina e *gozhdë-bollonave*, ~~miniera e hekur-nikelit~~, Fakulteti i *histori-filologjisë*, fushata e *korrrje-shirjeve*, ndërmarrja e *letër-përpunim-drurit*, fabrika e *lëkurë-këpucës*, industria e *material-ndërtimit*, uzina e *ndërtim-montimit*, ~~punonjësit e ngarkim-shkarkimit~~, repartet e *punim-drurit*, prodhimi i *qelq-qeramikës*, kooperativa e *riparim-shërbimit*, reparti i *riparim-maqinave*, ~~kooperativa e shërbim-ndërtimit~~, NMSH e *shpim-kërkimit*, brigada e *shpim-shfrytëzimit*, ~~seksioni i shpim-vlerësimit~~, fabrika e *tekstil-leshit*, etj. Janë prodhim i terminologjisë speciale, nuk gjejnë modelin e vet semantik në gjuhë dhe nuk mund të trajtohen si fjalë. Po t'i zbërthenim ato sipas modeleve semantike të gjuhës, atëhere *gozhdë-bullona* do të ishte «një gozhdë në trajtë bullone» dhe *qelq-qeramika* një lëndë e vetme.

Rastin më të vështirë e përbëjnë disa togje «me përcaktim rasor», në trajtën e shquar të të cilave është krijuar një paradigmë tërësore nëpërmjet shndërrimit të mbaresës së rrjedhores së pashquar në mbaresë të emërores së shquar. Ky grup është studjuar në një farë shkalle dhe në bazë të kriterëve të pranuar duhet trajtuar si një tip me strukturë gjysmë të hapur: në të shquarën si fjalë e në të pashquarën si togfjalësh. P.sh. *barpeshkun* (*Verbascum* sp. dis.): bar peshku, *çajmalin*: çaj mali, e *fletënderit*: fletë nderi, e *fletëlavdërimit*: fletë lavdërimi, e *gojasllanit* (lule): gojë asllani, *gurkalin*: gur kali, *gjeldetin*: gjel deti, e *kallamsheqerit*: kallam sheqeri, e *lulediellit*: lule dielli, *panxharsheqerin*: panxhar sheqeri, e *pendëkaposhit* (*Stipa* sp. div.): pendë kaposhi, *pulëdetin*: pulë deti, e *qymyrdurrit*: qymyr druri, e *qymyrgurit*: qymyrguri, *vajgurin*: vaj guri, e *vajlirit*: vaj liri, e *vajpeshkut*: vaj peshku etj. Formime të tilla janë përpunuar në fushën e ligjërimit të thjeshtë, por kanë fituar një qëndrueshmëri në gjuhën e folur përgjithësisht dhe drejtshkrimi nuk mund t'i kapërcejë pa i përfilluar sepse qoftë edhe si mjete të ligjërimit të thjeshtë, dalin në letërsinë artistike në gojën e personazheve. Fjalë të tilla ende nuk e kanë krijuar temën e së pashquarës (çajmal, fletënder, gurkal, gjeldet, lulediell, etj., sikurse *bregdet*, *fletërrufe* etj.<sup>18</sup>).

Në një shkallë më të lartë njëfjalësi kanë arritur sot fjalët e formuara me përcaktim rasor nëpërmjet neutralizimit të mbaresës rasore, si *bishtpelzë-a* (*Festuca varia*), *ditëpunë-a*; *fletëluftarake-ja*, *lulelakër-a*, *lulequmështore-ja* (*Sonchus*), *luleshpatë-a*, *nusëlalë-a*, *punëdore-ja*, *rrugëzgjdhje-a* etj.<sup>19</sup>, megjithë përdorimin ende të gjallë të togjeve paralele *ditë pune*, *nusja e lalës* etj.

Një problem më vete përbën gjendja leksikosemantike dhe drejtshkrimi i disa njësive bitematike me zanore tematike ose lidhëse -o-. Në «Projektin e rregullave të drejtshkrimit...», duke u mbështetur, me sa duket, në shkallën e bashkësisë kuptimore, janë dhënë dy zgjidhje të ndryshme: a) shkruhen bashkë «fjalët e përbëra e të pë-

18) Rrallë ndeshen edhe trajtat e emërores së pashquar me një formim regresiv analogjik, madje edhe në ndonjë fjalor, si *vajgur-i* (Fjalori i gjuhës shqipe, 1954), *gurkal-i* (K. Tasi, *Fjalor greqisht-shqip*, 1934), *gurzjarr* (F. Cordignano, *Fjalor shqip-italisht*, 1934, dhe A. Leotti, *Fjalor shqip-italisht*, 1937).

19) Por, përkundrajt këtyre kemi: çantë dore, krah pune, mana toke, rend dite etj. — si togje.

ngjitura» si *anarkosindikalist, anglosakson, elektromagnetik, empirio-kriticizëm, feudaloborgjez, gushtovjeshtë, neofashist, neopozitivizëm, neorealizëm, neozelandez, otorinolaringolog, pseudopatriot, serbokroatishtja* (E § 1,2), dhe b) «Do të shkruhen me vizë lidhëse mbiemrat dhe emrat e përbërë me gjymtyra të barasvlershme, të cilat kanë midis tyre lidhje këpujore», si: *afro-aziatik, anglo-amerikan, austro-hungarez, balto-sllav, franko-gjerman, greko-romak, shqiptaro-grek, trako-ilir etj.; agraro-industrial, analitiko-sintetik, ekonomiko-shoqëror, gjeografiko-historik, ideo-politik, kulturalo-politik, monarko-fashist, politiko-shoqëror, tekniko-material, ushtarako-politik etj.* (E § 2,9). Është e vërtetë se këtu kemi bashkësi kuptimore të shkallëve të ndryshme si dhe tipe të ndryshme strukturore, por ato afrohen nga një tipar qenësor, nga struktura e mbyllur. Siç kemi theksuar edhe një herë tjetër<sup>20</sup>, «për kompozimin në shqipe nuk përbën problem lidhja e temave, si rrjedhim viza ndërmjet gjymtyrëve është e panevojshme, për më tepër se ndan temën nga tema, jo fjalën nga fjala, gjersa në kompozita kemi bashkim temash». Lidhur me këtë shtojmë se edhe funksionet e vizës duhet të kuptohen qartë: ajo jo vetëm i bashkon dy gjymtyrë, por edhe i ndan dhe ky funksion i dytë nuk duhet harruar gjatë përdorimit të saj. Këtu përgjithësisht, si për kompozitat e tipeve të tjera, formësimi gramatikor tërësor flet për leksikalizim të kryer përfundimisht dhe viza, pas zanores lidhëse -o-, është pa kuptim, madje e përdorur gabim. Mendoj se viza nuk duhet të përdoret për të lidhur temat, pra jo si shenjë e përbërjes (po ashtu edhe për përngjitjen), por si shenjë e lidhjes së fjalëve, që hyjnë në një bashkëmarrëdhëje me bashkësi kuptimore të dobët e me vlerë të barabartë njëra kundrejt tjetrës. Sipas kësaj, duhen shkruar bashkë e pa vizë, si një fjalë e vetme, gjithë njësitë me zanore lidhëse, si: *anatomofiziologjik-e, ekonomikoshoqëror-e, mikroorganizëm-i, muzikoletrar-e, skllavopronar-i, teknikoshkencor-e, termocentral-i etj.*<sup>21</sup>. Këtu

20) SF 1968 IV 184.

21) Po kështu: *agraroindustrial-e, agrozooteknik-e, aminoacid-e, anatomopatologjik-e, angloamerikan-e, asfaltobeton-i, çifligaroborgjez-e, detarotregëtar-e, elektrogjenerator-i, elektrooptik-e, elektroradioteknik-e, fantastikoshkencor-e, fiskulturalo-sportiv-e, fizikomekanik-e, fiziopatologjik-e, gastrointestinal-e, gjeografikofizik-e, gjeografikohistorik-e, gjeologomineral-e, hidrosanitar-e, higjenikosanitar-e, higjenosanitar-e, historikoshoqëror-e, ideoestetik-e, imperialistorevizionist-e, industrialo-agrar-e, inxhinieroteknik-e, jonosferë-a, materialoteknik-e, monarkofashist-e, monarkofashist-i, morfofiziologjik-e, raketobërthamor-e, serbomadhe, skllavopronar-e, teknikoorganizativ-e, teknikoprofesional-e, teknikoshkencor-e, etj.* Formimet me zanoren lidhëse -o- në rakisht kanë një grafi dylllojëshe: зубробизон, железобетон, шлакобетон, светотень, песотундра, etj. dhe юго-восток, северо-запад etj. Ky dallim është mbështetur, siç shihet, mbi kriterin e ndërtimit semantik, gjë që, padyshim, duhet pasur parasysh edhe për tipin *hotel-restorant*. Një analizë më e imët semantike e këtij tipi do të na zbulojë se, së paku si emërtim, *hotel-restorant* tregon dy objekte të lidhura apo një objekt me dy funksione. Ky përcaktim i dyanshëm, si dhe struktura ndërmjetëse, ka shkaktuar që të ketë lëkundje mendimesh edhe në vetë përcaktimin e njërive të tilla, si fjalë të përbëra apo si togfjalësja. Duke marrë tipin *telefon-automat, pilot-kozmonaut, socialist-revolucionar, divan-kreat, vagon-restorant, nënë-heroinë* etj., që në rakisht shkruhen me vizë në mes, Z. A. Potika shpreh edhe një herë lëkundjen e njohur të mendimit shkencor për vlerësimin e këtij tipi. Ajo shkruan: «Nga njëra anë, këto fjalë bashkohen me fjalët e përbëra, sepse janë njësi leksikore, por, nga ana tjetër, ato përbëhen nga dy emra të pavarur, që ruajnë lakimin paralel të të dy komponenteve (krh.



duhen përfshirë edhe rastet kur tema e parë e fjalës mbaron me -o, e cila kryen këtu edhe funksionet e zanores lidhëse, si: autoambulancë, banjomari, biokimi, fotoaparati, fotoekspozitë, ideoartistik, ideoestetik, ideopolitik, ideoprofesional, ~~kinoarshivë~~, kinoklub, kinooperator, kinostudio, kinoteatër, radiomarrës, radiopërhapje, ~~radioreportazh~~, radiostacion, radiovalë etj.

Duke e kuptuar në këtë mënyrë funksionin e vizës, duhet ta përdorim atë, ~~ashtu siç thuhet me të drejtë në «Projektin e rregullave të drejtshkrimit...» (E § 2,14)~~, në «të gjitha formimet e përfutuara nga përsëritja e së njëjtës fjalë, nga bashkimi i dy antonimeve, i dy numërorëve themelorë.. dhe në formime onomatopeike». Ky formulim përmban brenda kriterin e drejtë: për të lidhur dy fjalë me vlerë të barabartë semantikofunksionale njëra kundrejt tjetrës, si tipi *hyrje-dalje*, *pritje-përcjellje*, etj.; *hotel-restorant*, *qen-ujk* etj., fjalor *latinisht-shqip* etj.; *Fier-Shegan* etj., *copë-copë*, *lloj-lloj* etj.; *tokë-ajër* etj. *bam-bam*, *ciu-ciu*, etj.; *dy-tri* faqe, *pesë-gjashtë* ditë etj.<sup>22</sup>

Për të ndjekur besnikërisht këtë kriter që po trajtojmë, duhen shtuar këtu si njësi që shkruhen me vizë edhe ato struktura të hapura që përbëhen nga fjalë gramatikusht homogjene dhe që kanë paradigmë paralele për të dyja gjymtyrët, si p.sh. muzeumi *arkeologjik-etnografik* // kërkimet *arkeologjike-etnografike*, botëkuptim *ateist-shkencor* // përmbajtje *ateist-shkencore*, indeksi *bujqësor-blegtoral* // kooperativë *bujqësore-blegtorale*, institucion *higjenik-sanitar* // masa *higjenike-sanitare*, institut *kërkimor-shkencor* // puna *kërkimore-shkencore*, botëkuptim *marksist-leninist* // grupet *marksiste-leniniste*, plan *mësimor-shkencor* // puna *mësimore-shkencore*, ~~boshti politik-ideologjik~~ // përmbajtja *politike-ideologjike*, institucion *social-ekonomik* // masa *social-ekonomike*, institucion *social-kulturale* // institucione *social-kulturale*, etj. Këto nënkuptojnë struktura fillestare këpujore me gjymtyrë të njëvlershme, si muzeumi *arkeologjik dhe etnografik*, indeks *bujqësor dhe blegtoral*, ~~boshti politik dhe ideologjik~~ etj. Kështu kemi paralelisht të përdorura nga njëra anë *bujqësoro-blegtoral*, *higjenikosanitar*, *marksistleninistët*, *ekonomikosocial*) etj. si

телефона-автомата, телефону-автомату, телефоном-автоматом Ato, në thelb, fjalëshja me ndajshtim». З. А. Потиха, Современное русское словообразование; Moskë 1970, f. 271. Janë semantikusht të papranueshme si kompozita disa formime të ngjashme me grupin e mësipërm, me zanoren lidhëse -o-, që dalin dendur kohët e fundit në shtypin tonë, por që nuk përputhen me modelet semantike të shqipes, si amerikanolatin-e, gjermanofederal-e, gjermanoperëndimor-e, gjermanoperëndimor-i, irlandezoverior-e, irlandezoverior-i (edhe *jugamerikanët*, *veriirlandezët*), latinoamerikan-e, latinoamerikan-i, vietnamezojugor-e, vietnamezojugor-i etj.

22) Po japim edhe disa shembuj të tjerë që nuk gjinden në rregullat e drejtshkrimit: *avash-avash*, *bardhë-zi*, *bile-bile*, *bojra-bojra*, *blu-saks*, *brazda-brazda*, *brigje-brigje*, marrëdhënjet *burrë-grua*, *copa-copa*, *çifte-çifte*, *dallgë-dallgë*, *dhëmbë-dhëmbë*, titulli «*dhënje-marrje*», *fitila-fitila*, *gati-gati*, *glluq-glluq*, *gropa-gropa*, *grumbuj-grumbuj*, *gjysma-gjysma*, *hollë-hollë*, shtyllat «*hyrje-dalje*», *iliq-iliq*, *jar-gë-jargë*, *krahë-krahë*, *lehtë-lehtë*, periudha *mars-prill*, marrëdhënjet *mësues-nxënë*, *mirë-keq*, *orë-orë*, *pëllëmbë-pëllëmbë*, *qetë-qetë*, *qime-qime*, *rehat-rehat*, *rrathë-rrathë*, *rreshta-rreshta*, *rrëke-rrëke*, *stiva-stiva*, *shkulme-shkulme*, *shtresa-shtresa*, *shtruar-shtruar*, *shumë-shumë*, *tek-tuk*, *trak-trak*, *trumba-trumba*, *thellë-thellë*, *ujra-ujra*, *biletë vajtje-ardhje*, *veri-lindje*, *veri-perëndim*, *xixa-xixa*, *xhan-xhin*, *yrnekë-yrnekë* etj. Pavarësisht nga dallimet semantike, të gjitha shkruhen njësoj.

njësi njëfjalëshe që shkruhen bashkë dhe nga ana tjetër *bujqësor-blegtoral, higjenik-sanitar, marksist-leninist, ekonomik-social* etj. si njësi njëfjalëshe që shkruhen bashkë dhe nga ana tjetër *bujqësor-blegtoral, higjenik-sanitar, marksist-leninist, ekonomik-social* etj. si njësi me strukturë të hapur, të panjëfjalësuar ende, si togfjalësha. Padyshim, ka edhe dallime kuptimore ndërmjet tyre, prandaj në këtë ndarje, bashkë me kriterin morfostrukturor duhet të kihet parasysh edhe kriteri semantik<sup>23</sup>.

Me këto besojmë se është shpjeguar në mënyrë të mjaftueshme tipi i togfjalëshave *gur kufiri, bukë gruri, ve pate, lëng pule* etj. që u zu në gojë më parë<sup>24</sup>. Një shkallë shumë të lartë ka arritur përbërja e përngjitja, d.m.th. njëfjalësimi me strukturë të mbyllur, në topo-nomastikë<sup>25</sup>.

Duke mbyllur shënimet për tiparin morfostrukturor, duhet theksuar se me gjithë këto, ai nuk duhet absolutizuar si kriter dallues, sepse, së pari, ai nuk mund të zbatohet për të gjitha kategoritë e fjalëve (p.sh. për fjalët pa forma gramatikore, si ndajfoljet, parafjalët etj.) dhe, së dyti, se shumë njësi janë ende në kapërcyell të formimit të tyre si fjalë, siç u pa me dy struktura: të hapur e të mbyllur<sup>26</sup>. Gjithë kjo çështje paraqitet këtu e thjeshtësuar, kurse në të vërtetë ka shumë procese të brendshme zhvillimi e ndryshimi të formës e të përmbajtjes, që e largojnë fjalën nga togfjalëshi. Një zhvillim në vijë të drejtë të kompozitës nga togfjalëshi sintaktik, ashtu siç mendohet nga një herë, nuk ka. Thuhet se lidhjet gjymtyrore të kompozitës mund të jenë sintaktike, por mund të jenë edhe asintaktike. Llojet e lidhjeve sintaktike (përshtatje, drejtim, bashkim), që shprehen në togfjalëshin e lirë, nuk dalin fare në kompozitën. Mjafton të krahasohen për këtë *syzezë* (*sy-* m. + *-zezë* f.), *mendjemadh* (*mendje-* f. + *-madh* m. etj.), ose *zemërgurë*, ku — *gurë* nuk funksionon veçan në gjuhë. Sipas konceptit asintaktik të kompozimit, gjatë formimit të fjalëve të përbëra shuhet çdo lidhje sintaksore. Fjala e përbërë dallohet nga togfjalëshi jo vetëm nga struktura, por edhe nga semantika. Në fjalën e përbërë marrëdhënjet kuptimore të gjymtyrëve janë më të përgjithshme dhe të paaktualizuara. Siç dihet që nga F. De Sosyri,

23) Në botimet tona të të gjitha llojeve një dallim i tillë nuk bëhet e kemi kështu një mori variantesh shkrimore e një përzjerje pa kriter të këtyre varianteve. Kjo gjë flet për mungesën e një rregulle të saktë dhe të një tradite të ngulitur, por edhe për fazën ende fillestare në të cilën ndodhet vetë procesi i formimit të njësive njëfjalëshe, si dhe për një përzjerje të tipit njëfjalësh me tipin togfjalësh. Në disa tekste të reja shkollore vihet re një kujdes i veçantë, ndonëse gjithnjë në mënyrë empirike, për ta pasqyruar këtë prirje drejt njëfjalësimit dhe për ta ndarë tipin me -o- nga gjeneza e tij. Shih si shembull për këtë «*Librin e gjuhës shqipe*» për klasën VI, 1972.

24) Gjithashtu nuk shtojmë gjë më shumë edhe për tipin *dita-ditës, dora-dorës, hera-herës, këmba-këmbës* etj. (E § 2, 14), i cili është trajtuar në studimin «*Një klasifikim i frazeologjizmave...*», SF 1969 I 13-14.

25) Shih për këtë A. Kostallari, *Kontribut për klasifikimin e tipave kryesorë të kompozitave në fushën e mikrooronimisë shqiptare*, SF 1971 III 52-53v. (më tipikë janë shembujt: *Vijat e Gurigravet, Gryka e Lugudiellit, Masgurëzalli, Ndërmjetshpella* etj. f. 56).

26) Në fushën e trajtëformimit shembulli më i dukshëm i këtij paralelizmi, por në mjete gramatikore të ndryshme, është ballafaqimi i kohëve të pathjeshta të mënyrës dëftore me ato të habitores: *kam folur* (*ke folur, ka folur* etj.) dhe *folkam* (*folke, folka*, etj.).

në gjuhësi dallohen fusha e emërtimeve dhe fusha e raporteve<sup>27</sup>. Fjala e përbërë bën pjesë në të dyja fushat, veçse është karakteristike për fushën e emërtimeve, raportet ajo i jep në mënyrë shumë të përgjithësuar, në një shkallë të ulët aktualizimi. Përkundrazi, togfjalëshi me strukturë të hapur, me tregues gramatikorë shumë të pasur, me mjete të tjera aktualizimi (si nyje, parafjalë, lidhëza etj.) shpreh në mënyrë të veçantë edhe raporte, madje edhe nuanca të tyre, në formë të aktualizuar.

III. Me këtë të fundit lidhet një tipar tjetër i fjalës që e dallon atë nga togfjalëshi i lirë: desemantizimi i gjymtyrëve, jo vetëm në kuptimin e përmbajtjes, por edhe të raporteve të brendshme, të funksioneve, të formës së shprehjes etj. Duke shkruar për këtë çështje A. Kostallari thekson se «...çdo fjalë e re që krijohet, kur vihet në përdorim, menjëherë, në këtë ose atë shkallë, leksikalizohet, struktura semantike e saj, «forma e saj e brendshme» fillon të errësohet, të mos ndihet, ndërsa formohet e përforcohet raporti i drejtpërdrejtë i saj me realitetin»<sup>28</sup>. Siç shihet, desemantizimi lidhet drejtpërdrejt me leksikalizimin e njësisë gjuhësore. Desemantizimin në planin e përmbajtjes ne mund ta shohim në vetë gjymtyrët përbërëse të fjalëve, po si kriter dallues i kufijve të fjalës në vargun e njësisive të tjera gjuhësore ai na ndihmon veçanërisht për grupin e fjalëve njëtrajtëshe (për ndajfoljet, parafjalët, lidhëzat etj.). Në një grup ndajfoljesh, parafjalësh, lidhëzash e pjesëzash të pathjeshta ky desemantizim shfaqet me zbehjen e kuptimit të fjalëve që i përbëjnë ato dhe me një risemantizim jo të gjymtyrëve veç e veç, po të përngjitjes në tërësi. Për këtë mund të vëzhgohen shembujt *asgjë, kushedi, mësysh, mezi, ndërkohë, përtej, përjetë, përherë, përfund, pasdore, parasysh, papritur, qyshkur, sadokudo, tanimë, (tashmë), etj.; domethënë, gjithaq, meqenëse, mënjane, mirëpo, nëqoftëse, drejtpërdrejt, ndonëse, pajjalë, patjetër, sidoqë, sidoqoftë, sikur, teksa, tërëmonë etj.* Emrat (*gjë, sy, zi, kohë, jetë, herë, fund, dorë, fjalë, mot, etj.*), foljet (*di, pres, dua, them, jam etj.*), ndajfoljet (*tej, kur, tani, aq, mirë, drejt etj.*), fjalët shërbyese (*as, e, më, me, ndër, pas, sa, se, po, në, për, si, tërë, etj.*), që kanë hyrë në përngjitjet, nuk ruajnë veçse gjurmë të errëta të kuptimit të tyre fillestar. Po të marrim foljen *jam* tek *nëqoftëse, sidoqoftë etj.*, vërejmë se ajo ka humbur jo vetëm kuptimin leksikor kategorial (kuptimin e veprimit si folje), por edhe kuptimin leksikor individual (të qenë, të ndodhur). Kështu ajo ka humbur pavarësinë semantiko-funksionale dhe si e tillë nuk mund të funksionojë veçse brenda së tërës (njësisë së përngjitur) dhe vetëm në shërbim të saj. Ky nënshtrim e kjo ndërvarje semantikofunksionale tek disa mbiemra (si *syzi, derëzi, ditëzi, mendjemadh, shpirtvogël, etj.*) shfaqet edhe në raportet e brendshme, kurse tek disa ndajfolje shoqërohet me ndryshimin e këtyre raporteve (si: *njëseri, përfundI, qëmotI, atyparI, qëparI etj.*, ku I-ja fundore, thyen strukturën e togjeve gjenetike një zë, për fund,

27) Shih për këtë edhe V. Г. Адамс, Язык как единство системы отношений и системы построения, në „Филологически науки“, 1963 III 15.

28) A. Kostallari, *Kompozitat dëshirore...*, SF 1968, IV, 57.

që(një)mot, aty(më)parë, që(më)parë etj.), ose me një riformësim tërësor sipas modelesh ekzistuese (si: *papritmas, njënatëzaj* etj.)<sup>29</sup>.

(Mendoj se) për këtë arsye duhet të merren si një fjalë e vetme edhe disa formime me «zgjerim përngjitjeje», si: *ballë-përballë — ballëpërballë, brenda-përbrenda — brendapërbrenda, dashur-padashur — dashurpadashur, dalë-ngadalë — dalëngadalë, ndonjëherë — ngando-njëherë, drejt — drejtpërdrejt (drejtpërsëdrejti), doemos — medoemos, përmes — mespërmes, prapë — prapëseprapë* etj.<sup>30</sup>.

Një pikë të diskutueshme nga pikëpamja leksikologjike përbën edhe kufiri ndërmjet disa frazeologjizimeve dhe fjalëve të përngjitura (delokutivëve) që dalin prej tyre. Në krye duhet të ndajmë veç grupin me marrëdhënje lidhëzore (këpujore) nga të tjerat. Kur janë leksikalizuar plotësisht këto frazeologjizime dhe i janë nënshtruar një paradigme të gjallë, atëherë s'ka dyshim që do të trajtohen si fjalë e do të shkruhen bashkë (si: *ecejakET* etj.). Mirëpo jo gjithmonë na vjen në ndihmë ky kriter. Po kështu nuk mund të shtjemë në përdorim këtu kriterin semantik dhe atë të desemantizimit, sepse këto janë të përbashkëta edhe për frazeologjizime në përgjithësi. Mendojmë se pas këtyre marrin vlerë dy kushte të tjera: së pari, tradita, ngulitja në vetëdijën gjuhësore dhe në shkrim e njërës trajtë dhe, së dyti, pozicioni sintaktik dhe natyra e lidhjeve sintagmatike të njësisë. Sipas këtyre kushteve mund të trajtohen si fjalë *anëmbanë, deleduk, digjepiq, hajevill, tejetej, zhytembyt* etj. Pavarësisht nga tradita shkrimore, ka edhe një grup njësisish që janë në kapërcyell nga frazeologjizime në fjalë. Tani ne vetëm konstatojmë gjendjen e tyre dyformëshe dhe të ardhmen e tyre drejt përngjitjes, si: *anekënd, fëtefët, fundekrye, kokekëmbë, kryqetërthor, lesheli, mbareprapë, oreçast, rretheqark, rretherreth, rretherrotull, shendeverë, tejëmbanë, tejëndanë*, etj. Në rrugën e përngjitjes këto njësi ecin të gjitha, por jo në të njëjtin ballë.

29) Me këtë kriter mund të klasifikohen si fjalë që duhen shkruar bashkë edhe disa përngjitje të tipit *mosozot, zotnaruaaj, vrazot, hajdehujdi* etj. Siç ka vënë re edhe A. Kostallari, «...gjatë transformimit të apelativave në oronime vihet re në përgjithësi një prirje për desemantizim të plotë o të pjesshëm (krh. *Uji i Delujit, Kroni i Gurradoçit* etj.)», — *Kontribut...*, SF 1971 III 58.

30) Në trajtimin e pasthirmave duhet pasur një kujdes i veçantë, që të mos rrëmbehemi tërësisht nga mendimi kategorik se «çdo pasthirmë është një fjalë». Së pari, duhen ndarë nga grupi i pasthirmave onomatopetë (si: *bum-bum, paf-puf* etj.), të cilat nuk kanë kuptim leksikor, as shprehin emocione dhe kështu nga ana leksikologjike nuk janë fjalë. Përsa i përket drejtshkrimit të tyre është i drejtë mendimi i shprehur nga E. Angoni, që kur nga një onomatope formohet njësi leksikore e pavarura e me funksion emërtues, atëherë do të shkruhet bashkë (si: *fëshfëshe-ja, taketukë-ja, dërdëlis* etj.); po këtu duhet të përfshihet edhe tipi që e shkruajnë me vizë (si: *tiktaku* i sahatit; *traketruket* e potkonjve etj.). Si në kategoritë e tjera leksikogramatikore, edhe në grupin e pasthirmave duhet të pranojmë edhe lokucione e togje analitike të ndërtuara me mjete leksikore të pavarura, ashtu siç e ka në të vërtetë struktura e gjuhës. Kështu, krahas *mirë-dita, mirëmbërëma, mirupafshim, tungjatjeta, lamtumirë* etj. do të pranojmë edhe të *falem nderit* (të *falemi nderit, ju falem nderit, ju falëm nderit*), *mirë se erdhe* (*mirë se na erdhe, mirë se erdhët, mirë se na erdhët*), *mirë se vjen* (*mirë se na vjen, mirë se vini, mirë se na vini, mirë se të vish, mirë se të vijë, mirë se të vini, mirë se të vijnë*), *mirë se të gjej*, (*mirë se ju gjej, mirë se të gjejmë, mirë se ju gjejmë, mirë se të gjeta, mirë se ju gjeta, mirë se të gjetëm, mirë se ju gjetëm, mirë të gjetsha* etj.), si *urdhëron* (si *urdhëroni, si urdhëruat, si të urdhëroni* etj.), *udhë e mbarë* (*udhën e mbarë*) etj.

(njësi)

Disa (si: *kokë e këmbë, kryq e tërthor, mbarë e prapë, shend e verë*) janë më prapa, të tjerat më përpara. Më pas akoma janë disa frazeologjizime të tjera, si *natë e ditë, hundë e buzë, majë e brisk, kashtë e koqe, urtë e butë, gjerë e gjatë, hollë e hollë, poshtë e lartë, andej e këndeje, sot e tutje, rrallë e tek, fije e për pe etj.* të cilët tani për tani duhet të shkruhen veças. Në të ardhmen, kur t'i ketë kristalizuar më tej vetë gjuha dhe t'i ketë shoshitur më mirë studimi ynë, do të duhet patjetër të bëjmë ndryshime edhe në drejtshkrimin e tyre. Për tipin ndajfoljor të ndërtuar nga dy gjymtyrë të njëjta e të lidhura me parafjalë, (si: *gojë më gojë, brez pas brezi, dhemb për dhëmbë, sy në sy etj.*), zgjidhja e ~~«Projektit të rregullave të drejtshkrimit...»~~, (DH § 2, 1-4) mbetet e drejtë. Po kështu mbetet i drejtë edhe trajtimi i frazeologjizimeve me gjymtyrë foljore me marrëdhënie këpujore si: *çap e jakë, ec e jakë, folë e qesh, laj e lyej, qesh e ngjesh, shkel e shko, shih e shkruaj e ndonjë tjetër*<sup>31</sup>.

IV. Si një kriter ndihmës për të vënë kufi ndërmjet fjalës dhe togfjalëshit mund të merret edhe sistemi i lidhjeve që krijojnë njësia e dhënë me njësitë e tjera brenda sintagmës ose brenda së njëjtës fushë gjuhësore. Ky sistem raportesh është i gjërë e i shumanshëm dhe në këtë kuadër frazeologjizime herë-herë ka tipare të njëjta me fjalën. Si njëri edhe tjetra marrin po ato funksione sintaksore brenda fjalisë dhe kanë po ato lidhje sintaksore brenda sintagmave e togfjalëshave. Mjafton të krahasojmë për këtë paralelet: «e priti me krahë hapur» dhe «e priti krahëhapur». Prandaj kur flitet për kriterin e lidhjeve sistemore duhet të përfillen jo vetëm lidhjet sintaksore, por edhe semantike<sup>32</sup> e fjalëformuese. Këtyre mund t'u shtohen edhe lidhjet e reja që një njësi e rishformuar krijojnë me fjalët e tjera në sistemin leksikosemantik, si ato të sinonimisë, të antonimisë etj.

Duhet marrë gjithashtu në vështrim edhe ballafaqimet e strukturave të njëjta, si: *më tej — më tutje — më thellë — më lart etj.*, ose *shpesh herë — dy herë — shumë herë — disa herë etj.*, që tregojnë se s'kemi të bëjmë këtu me fjalë, po me togje fjalësh. Fjalët që krijojnë mbi bazën e togfjalëshave (edhe të tipit frazeologjik) hyjnë menjëherë në një klasë të caktuar leksikogramatikore dhe fitojnë të gjitha tiparet, funksionet e lidhjet sistemore të kësaj klase. Nëpërmjet këtyre lidhjeve ne dallojmë, p.sh., se tek «dhjetë litra vaj guri» kemi një togfjalësh, kurse tek «shitja e vajgurit» kemi një fjalë. Veçanërisht për pjesët e palakueshme të ligjëratës ky kriter ka vlerë

31) Në studimin «Një klasifikim i frazeologjizmave...» SF 1969 I 15-23, kam pranuar pothuaj këto zgjidhje, me përjashtim të shtesës për disa njësi (si: *anekënd, fëtefët, lesheli etj.*), që tashmë mund të merren si fjalë të përngjitura. A. Kostallari trajton edhe tipin *shkeleshko, foleqesh, lajelyej, zhytembyt, ecejakë, çapejak etj.* «si, përngjitje këpujore», por me rezervën që «disa herë qëndrojnë midis juxtapozicionit e atyre frazeologjizmave gjuhësorë që janë ekuivalentë me një fjalë. Për këtë arsye këto formime nuk kanë gjetur një trajtim të njëjtë nga studjuesit e shqipes.» — *Kompozitat dëshirorë...*, SF 1968 IV 53-54. Ky tip ka dy lloje lidhesh sintagmatike, që i japin atij herë tipare të fjalës e herë të frazeologjizimit. Krah. «Ai është foleqesh me të gjithë» dhe «Tërë ditën folë e qesh ai, si s'u lodh?», ose: «Si s'u lodhe ecë e jakë gjithë ditën?». Pra, me vlerë predikative ato janë frazeologjizime dhe kanë një kuptim disi më të drejtpërdrejtë. A. Xhuvani nuk i merr si ndajfolje të përngjitura.

32) Shih shënimin 3.

më të madhe. Tek ato valenca e jashtme ndihmon për të përcaktuar edhe kuptimin e përgjithshëm kategorial të njësisë. Nga ana tjetër, kristalizimi i disa njësive si tema trajtëformuese e fjalëformuese<sup>33</sup> flet për një shkallë të lartë njëfjalësimi të këtyre njësive e në të njëjtën kohë, me një veprim të përkundërt, ndikon këtë njëfjalësim, e forcon atë. Kjo duket tek tipat *dyngjyrësh-E*, *shumëgarësh-I* dhe *VAJGURsjellës*.

V. Ka edhe një faktor fonetik që është vlerësuar si kriter dallues i fjalës, ky është «faktori akcentologjik». Nuk ka dyshim se për fjalët e thjeshta e të prejardhura, si dhe për disa përngjitje (*trim*, *trimëri*, *kushtrim*) theksi i vetëm me intensitet të plotë është një tipar absolut. Mirëpo për disa përbërje e përngjitje të tjera pranohet një «theks kryesor» me intensitet të plotë në njërën gjymtyrë dhe një «theks i dytë» me intensitet të dobët në gjymtyrën tjetër. Në të njëjtat kushte akcentologjike janë edhe disa tipe frazeologjike. Prandaj mbi bazën e këtij kriteri është vështirë nga shqiptimi të ndajmë disa raste, kur kemi fjalë e kur frazeologjike, si: *foleqesh* apo *folë e qesh*, *shkeleshko* apo *shkel e shko*, *qeshengjesh* apo *qesh e ngjesh*, *ecejakë*, apo *ec e jakë* etj. Po të duam t'i mbahemi rreptësisht faktorit akcentologjik, atëhere mënyra empirike e vlerësimit të theksit është e pamjaftueshme; është nevoja për një studim eksperimental për të përcaktuar saktësisht intensitetin e thekseve në pozicione të ndryshme, në funksione të ndryshme të së njëjtës njësi, në njësi të ndryshme të të njëjtit tip dhe në tipin frazeologjik të ngjashëm nga ana akcentologjike *natë e ditë*, *gjërë e gjatë*, *lart e poshtë*, *mbarë e prapë*, *urtë e butë* etj., i cili në shqiptim del njësoj si *foleqesh*, *nateditë*, *urtebutë* etj.

\* \* \*

Duke përfunduar po ritheksojmë se problemi i dallimit të kufijve të fjalës në gjuhën shqipe, që ka kaq shumë lidhje të drejtpërdrejta edhe me drejtshkrimin, është mjaft i ndërlikuar e i vështirë. Do të arrihet në një zgjidhje përfundimtare vetëm pas studimit të fjalës në vetvete, pas përcaktimit të të ashtuquajturit «identitet» të saj, të veçorive të saj në të gjitha aspektet; semantik, morfostrukturor, fjalëformues, fonetik, funksional etj. Kjo do të thotë që asnjë kriter nuk mund të vlejë i vetëm për ta caktuar një njësi si fjalë, për këtë duhen vështruar shumë kritere, ndër të cilët spikat herë njëri e herë tjetri, po gjithnjë të gërshetuar së bashku. Pa një zgjidhje të tillë nuk mund të shpjegohen edhe shumë procese e kategori fjalëformuese, që lidhen ngushtë me sintagmat e togfjalëshat. Në fushën e fjalëformimit përbërja e përngjitja, si dy rrugë që sot kanë një prodhimtari të lartë, kanë

33) Me kompozitat si tema fjalëformuese A. Kostallari është marrë në mënyrë të veçantë në artikullin *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, BUSHT, SShSh 1962 III 3-45. Në një vend tjetër, duke bërë fjalë për tipin *vajguri*, *qymyrguri* etj. ai shkruan: «Hyrja e këtyre fjalëve si temë fjalëformuese në fjalë të tilla si *vajgursjellës*, *vajguror*, shtresa *vajgurmbajtëse*, *qymyrguror* etj. flet për shpejtimin e procesit të formësimit të tyre si kompozita» — *Mbi disa veçori...*, BUSHT, SShSh 1961 III 11.

*(emërime e foljore)*

më shumë nevojë për përcaktimin e kufijve të fjalës. Duhet gjurmuar më tej edhe përse në kategorinë nominale e verbale zotëron procesi i formimit me përbërje, kurse në fjalët shërbyese mbizotëron përngjitja. Ndoshta kjo lidhet me veçoritë morfostrukturore të fjalës.

Përcaktimi i kufijve të fjalës ka rëndësi të veçantë edhe në leksikografi, në punën për hartimin e fjalorëve të tipave të ndryshëm, ku detyrimisht do të mbahet qëndrim për çdo njësi leksikore një për një.

*«Projekti i rregullave të drejtshkrimit të shqipes» ka dhënë zgjidhje përgjithësisht të drejta. Për disa njësi e kategori që diskutojmë këtu ka edhe lëkundje, të cilat janë të natyrshme si nga gjendja e zhvillimit të vetë këtyre mjeteve gjuhësore, ashtu edhe nga shkalla e studimeve tona gjuhësore. (Zhvillimi i gjuhës, nga njëra anë, dhe thellimi i mëtejshëm i studimit të saj, nga ana tjetër, do të na çojnë në rregulla më të drejta e më të qëndrueshme drejtshkrimore. Përkrahja e prirjeve të zhvillimit të mëtejshëm të mjeteve e të dukurive gjuhësore do të jetë në këtë rast kriteri më i drejtë edhe për rregullat drejtshkrimore.)*

Duke qenë para hartimit përfundimtar të rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe, për shkrimin e fjalëve bashkë, ndaras a me vizë, mendoj se duhen pasur parasysh këto çështje:

1. Rregullat për shkrimin e fjalëve bashkë, ndaras ose me vizë përbëjnë një çështje të vetme drejtshkrimore dhe duhet të hartohen duke u mbështetur në konceptin shkencor për fjalën dhe veçoritë e saj në gjuhën shqipe. Trajta drejtshkrimore duhet të jetë shprehje e njësisë kuptimore dhe morfostrukturore të fjalës.

2. Në përcaktimin e konceptit të fjalës si njësi leksikore mbi bazën e tipareve të saj kryesore, jashtë ndikimit nga modelet e huaja, duhet të gërshetohen, siç u tha, një varg kriteresh, por pa i rrafshuar ato, sepse në realitetin gjuhësor diku spikat njëri kriter e diku tjetri.

3. Në gjendjen e tanishme të zhvillimit të gjuhës është nevoja që të hartohen rregulla drejtshkrimore edhe për grupe e kategori të tjera njësisë, që nuk përfshihen në projektin e vitit 1967. Nga ana tjetër, funksionet e mjeteve ndihmëse, si viza e zanorja lidhëse, të përcaktohen gjithnjë në përputhje me natyrën e shqipes dhe me ligjet e zhvillimit të saj të brendshme.

4. Në zgjidhjen e çështjeve për shkrimin e fjalëve bashkë duhet të përkrahët sa më shumë prirja për njëfjalësimin e njësisë leksikore, sidomos e disa lokucioneve parafjalore, lidhëzore etj.

5. Norma letrare, që pasqyrohet në rregullat e drejtshkrimit, nuk mund të lidhet vetëm me shkrimin bashkë, ndaras ose me vizë, por edhe me mospranimin e grupeve e të njësisë që vijnë në kundërshtim me këtë normë.